



Data: 11.02.2019

Ref.: 182/190

Në mbështetje të Nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-189, datë 16. 09. 2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25. 05. 2016), Nenit 7 dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29. 08. 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Mjekësisë, Nr.1410/18, datë 25. 10. 2018 për riakreditim të programeve të studimit:
 - Farmaci, PhD, 180 ECTS, dhe
 - Mami, BSc, 180 ECTS.

- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Mjekësisë (tash e tutje Fakulteti i Mjekësisë) ka parashtruar kërkesë (Nr.1410/18, datë 25. 10. 2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim të dy programeve të studimit si në vijim: Farmaci, PhD, 180 ECTS, dhe Mami, BSc, 180 ECTS.

Bazuar në Nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KSHC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Fakultetit të Mjekësisë, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1.2 të këtij neni, ku thuhet, *“Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”,* erdhi në përfundim se programet e studimit, Farmaci, PhD, 180 ECTS, dhe Mami, BSc, 180 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim nga KShC.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28. 09. 2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome*


Pas verifikimit të dokumentacionit relevant të stafit akademik, u konstatua që Fehmi Zeqiri me 27. 12. 2018 ka arritur moshën e pensionimit dhe i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit. Sipas nenin 67 të Ligjit të Punës, arritja e moshës 65 vjeçare është kusht ligjor për ndërprerja e Kontratës së Punës. Sipas paragrafit 1.4 të këtij neni, kontrata ndërpritet “kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç”.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit akademik sipas nenit 26, pika 5.3.4, ta refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Mami, BSc, 180 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Mjekësisë;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë